

NJOFTIM
Nr. 798, datë 13.6.2019
PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË SHËRBIMIT
GJEOLGJIK SHQIPTAR

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (Mjete kryesore + mjete xhiro)	Mjetet kryesore	Mjetet e xhiros	Trualli		
1	Objektet e Oficinës dhe Parkut të Gjeologjisë	Tiranë	60 172 446	60 172 446	0	141 468 260	4 780	2 153

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën** që vërteton ngurtësimin e 20 përqind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim: Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit, subjekti i shpronësuar Z. Myslym Kokonozi.

Afati i publikimit fillon më datë 17.6.2019 dhe mbaron më datë 16.7.2019.